

VENDIM
Nr.22, datë 24.3.2010

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË
NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronjat “c” dhe “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 23 pikat 1 dhe 3, nenit 24 pika 1 shkronja “ç”, nenit 54 pika 2 shkronja “e” dhe nënpika “i” të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 45 të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

- “Ndërmjetësimi për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit.”.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për t’i kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit European dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani